



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
QËNDRA E ARTIT DHE KULTURËS

Nr. 824 prot.

Korçë, më 24.05.2024

Lënda: Kthim përgjigje mbi ankimin ndaj refuzimit për dhenie informacioni dhe kopje të dokumentave zyrtare .

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

**DREJTORIA E PËRGJITHËSHME PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DREJTORIA
PËR VLERËSIMIN E ANKESAVE**

Rruga Abdi Toptani Nd. 5 Tiranë

Për dijeni: QËNDRËS “RES PUBLIKA”

Tiranë

Qendra e Artit dhe Kulturës Korçë u njoh me shkresën tuaj me nr. 1255 prot. datë 16.05.2024 për refuzim për dhenie informacioni dhe kopje të dokumentave zyrtare.

Së pari ju kërkojmë ndjesë për vonesën në përgjigje, por ju bejmë me dije se jemi informuar me vonesë nga Bashkisë Korçë se ciles ju i jeni drejtuar.

Informacioni që ka kërkuar “Res Publika”, përfaqësuar nga Z.Dorian Matlija me nr 55/24 prot datë 15.04.2024 është :

- 1. Sa është buxheti i parashikuar për artin dhe kulturën për vitin 2022-2023**
Ju bejmë me dije se janë publike në faqen e Bashkisë Korçë në sites:

<https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/transparenca-dhe-llogaridh%C3%ABnia-ekonomiko-financiare/buxheti/buxheti-vjetor-s%C3%AB-bashku-me-dokumentacionin-shoq%C3%ABruet-t%C3%AB-tij?authuser=0>

2. Sa nga ky buxhet është alokuar (shpërndarë sipas zërave).

Ju bëjmë me dije se ky informacion është përsëri i botuar publikisht po në sites :

<https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/transparenca-dhe-llogaridh%C3%ABnja-ekonomiko-financiare/buxheti/buxheti-vjetor-s%C3%AB-bashku-me-dokumentacionin-shoq%C3%ABruet-t%C3%AB-tij?authuser=0>

3. Kopje të listës së projekteve të financuara në art dhe kulture nga institucioni për vitet 2022-2023 ku të përfshihen të dhëna lidhur me titullin e projektit, vlerën e financiar, aplikanti përfitues, kohën e realizimit të projektit.

Kopja e listës së projekteve janë po në sites:

<https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/transparenca-dhe-llogaridh%C3%ABnja-ekonomiko-financiare/buxheti/buxheti-vjetor-s%C3%AB-bashku-me-dokumentacionin-shoq%C3%ABruet-t%C3%AB-tij?authuser=0>

Përsa i takon aplikantit përfitues në Qendrën e Artit dhe Kulturës Korçë, aprovimi i projekteve dhe zbatimi i tyre kryet në këtë mënyrë. Të gjitha propozimet vijnë para muajit tetor pranë QAKKorçë. Po këtë muaj të gjitha propozimet për projekte: teatrore muzikore, arte figurative kalojnë në bordin artistik dhe në zbatim të ligjit 10352 “Për artin dhe kulturën” nenit 10 dhe 11, marrin aprovimin e Bordit Artistik të Qendrës së Artit dhe Kulturës dhe Bashkisë Korçë. Të gjitha projektet miratohen në Këshillin Bashkiak, me titull projektit, me propozime buxheti sipas zërave përkatese, kështu që aplikantët janë të gjithë ata që kanë sjellë propozimet e tyre pranë Qendrës së Artit dhe Kulturës dhe ato që aprovohen vazhdojnë të implementohen për vitin në vazhdim.

Emrat e artistëve që ushtrojnë aktivitetin e tyre dhe përfitojnë fonde nga buxheti në bazë të projekteve të paraqitura janë të shumtë sipas nevojave të çdo projekti, regjizor, instrumentistë, kostumografë, aranzhues, grafik designe, koreografe, përkthyes, skenografë, poetë, libretistë etj, etj

Për sa u takon datave të realizimit të projekteve, bëjmë me dije se të gjitha aktivitetet implementohen në kohën kur vetë artistët e kanë programuar për tju përkushtuar koncertit, ekspozitës, apo shfaqjeve teatrore dhe në bazë të organizimit të kalendarit që bën Qendra e Artit dhe Kulturës Korçë. Për vitin 2022 numuri i projekteve të realizuara ishte 46, ndersa për vitin 2023 ishte 43, por ju sqarojnë se çdo aktivitet ka një numur protokolli sepse në zbatim të ligjit ato marrin datat përcaktuara të ofertave dhe kontratave dhe me pas të nxjerjes së premieres, shfaqjes, koncertit apo ekspozitës, spektaklit, festivalit apo për çdo aktivitet tjetër artistik.

Përsa i përket kërkesës suaj lidhur me datat e zhvillimit të aktiviteteve duke qënë informacion është voluminos duhet kohë.

Për çdo informacion tjetër mbetemi në kontakt.
Duke ju falenderuar.

Me Respekt!

DREJTORI
QËNDRËS SË ARTIT DHE KULTURËS

Zamira BEQIRAJ (KITA)

